



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTIRREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr.118, Datë 17.07.2020

“MBI  
LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË  
GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)”.

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, ”Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 50; 22, pika 2, gërma “ç” dhe nenit 83 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; si dhe neneve 4, pika 1, gërma “ç”; 5; 6; 8; 9 pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, gërma “e” dhe nenin 12 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.07.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 83/2 prot, datë 02.07.2020 përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve,dhe Mbikeqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë),

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 5, datë 10.01.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë GSA sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.
- Me shkresën nr. 41 prot, datë 14.01.2020, ERE ka përcjellë pranë shoqërisë njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësim të dokumentacionit
- Me e-mailin e datës 03.04.2020, për shkak të kufizimeve dhe situatës së krijuar nga COVID-19, shoqëria ka paraqitur kërkesë për shtyrje të afatit të plotësimit të dokumentacionit deri në normalizimin e gjendjes.
- Lidhur me këtë kërkesë të shoqërisë bordi i ERE-s është shprehur me vendimin nr.70, datë 22.04.2020, duke zgjatur me 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike afatin e vendimmarrjes finale për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror, për një afat 10-vjeçar, deri më 12.07.2020.
- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim nga ERE me shkresën nr. 651 prot, datë 22.04.2020.
- Shoqëria GSA sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 41/2 Prot, datë 19.06.2020, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar të aplikimit.
- Shoqëria “GSA” sh.p.k., ka kryer pagesën e aplikimit sipas kërkesave të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 97, datë 04.07.2017.
  - Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “GSA” sh.p.k., në bazë të nenit 9 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017, rezulton i **plotësuar**, si më poshtë vijon:

- Neni 9, pika 1 gërma a, b, c, d, e. **plotësuar.**
- Neni 9, pika 2 (i), (ii), (iii).
  - (i) Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në Milion Nm<sup>3</sup>, e parashikuar për t'u livruar gjatë një viti. **plotësuar.**
  - (ii) Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të Sistemit. Plotësuar pjesërisht. Shoqëria “GSA” sh.p.k. ka përcjellë në ERE një deklaratë në të cilën shprehet se planifikon të operojë në fushën e tregtimit të gazit natyror duke përdorur rrjetin e transmetimit TAP Ag dhe rrjedhimisht do të tregtojë gaz natyror me standardet e cilësisë që TAP Ag mundëson si dhe në përmbushje të të gjitha kriterëve të cilësisë që përcaktohen në rregulloret e aplikueshme në Shqipëri. Shoqëria deklaron se për shkak se ndodhet në hapat e para të licencimit, nuk disponon ende një marreveshje me TAP Ag, por sapo të nënshkruhet një e tillë do ta paraqesë në ERE.
  - (iii) Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej licencës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit. **plotësuar.**

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë), për një afat 10 vjeçar.
2. Shoqëria GSA sh.p.k. të depozitojë në ERE garancinë e cilësisë së gazit, para fillimit të ushtrimit të aktivitetit.
3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**